



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1-1/2022 regjistri (JD)  
Datë 27.03.2023

Nr. 1/1 i vendimit  
Datë 28.03.2023

**VENDIM  
PËR NDREQJE GABIMI**

Kolegji i Posaçëm i Apelitit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryetare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë në dhomë këshillimi, më datë 28.03.2023, ditën e martë, ora 16:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, kërkesën e bërë nga gjyqtarja relatore, me:

**Objekt:** Ndreqja e gabimeve në shkrim, në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, që i përket ankimit të z. Shkëlqim Kokona.

**Bazë ligjore:** Neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 80 dhe 1, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neni 312 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile.

**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,**

pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi, kërkesën e gjyqtarës relatore të çështjes mbi nevojën e ndreqjes së gabimeve në shkrim në vendimin nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, që i përket ankimit të z. Shkëlqim Kokona, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

1. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimin e tij nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, ka vendosur mospranimin e ankimit të z. Shkëlqim Kokona kundër vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Shkëlqim Kokona, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec”. Vendimi nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, është shpallur në datën 23.03.2023 dhe në datën e shpalljes i është njoftuar z. Shkëlqim Kokona, konfirmuar përmes nënshkrimit të tij, si edhe është dërguar për botim në Fletoren Zyrtare.
2. Pas komunikimit të vendimit nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, janë konstatuar disa gabime në shkrim në pjesën arsyetuese të tij dhe gjyqtarja relatore, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 27.03.2023, ka njoftuar për këtë konstatim Kryetaren dhe anëtarët e trupit gjykues, duke kërkuar ndreqjen e tyre.
3. Referuar kërkesës së gjyqtares relatore, nga Kryetarja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është nxjerrë urdhri nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2023, për thirrjen e seancës plenare në dhomë këshillimi, në datën 28.03.2023, ora 16:00, për ndreqjen e gabimeve në shkrim në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. 1 (JD), datë 20.02.2023. Ky urdhër i është njoftuar z. Shkëlqim Kokona dhe palëve të interesuara, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilët kanë konfirmuar marrjen e tij.
4. Në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 27.03.2023, gjyqtarja relatore kërkon ndreqjen e gabimeve në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, për sa vijon:
  - a) Në faqen 11 të vendimit, pas nënparagrafit të numërtuar 10.4.1., nënparagrafi vijues numërohet 10.4.2 dhe nënparagrafët më pas numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme në rend rritës.
  - b) Në faqen 21 të vendimit, në paragrafin 13.7, togfjalëshi “vendimit nr. 411, datë 17.02.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “vendimit nr. 411, datë 17.12.2021”.
5. Trupi gjykues, pasi u njoh me këto konstatime dhe kërkesën për ndreqjen e tyre, duke analizuar paragrafët e pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, në të cilët janë konstatuar gabimet, çmon se gabimet e konstatuara janë gabime në shkrim, ndreqja e të cilëve nuk ndryshon qëndrimin e Kolegjit qoftë në arsyetimin e vendimit dhe aq më pak në disponimin e tij në pjesën urdhëruese.
6. Në këto kushte, bazuar në nenet 80 dhe 1, pika 2 e ligjit nr. 8577/2000, si dhe nenin 312 paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji çmon se është e nevojshme që të kryhet ndreqja e gabimeve të konstatuara në formën e përshkruar më lart, në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, që i përket ankimit të z. Shkëlqim Kokona, duke saktësuar në përmbajtjen e tij, sipas konstatimeve të mësipërme, ndreqje që nuk ndryshon vullnetin e Kolegjit në dhënien e vendimit të sipërcituar.

## PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në nenet 80 dhe 1, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 312 paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile,

## VENDOSI:

1. Ndrejten e gabimeve në shkrim në arsyetimin e vendimit nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të z. Shkëlqim Kokona, si më poshtë:

**1.1.** Në faqen 11 të vendimit, pas nënparagrafit të numërtuar 10.4.1., nënparagrafi vijues numërtohet 10.4.2 dhe nënparagrafët më pas numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme në rend rritës.

**1.2.** Në faqen 21 të vendimit, në paragrafin 13.7, togfjalëshi “vendimit nr. 411, datë 17.02.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “vendimit nr. 411, datë 17.12.2021”.

2. Ky vendim i bashkohet vendimit nr. 1 (JD), datë 20.02.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është pjesë përbërëse e tij dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 28.03.2023.

**GJYQTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**GJYQTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYETARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*